

Njësia ekonomike:

SHOQERIA "LA PLAZA AL" SHPK

Të dhëna identifikuese:

NIPT: L515120221

Adresa:

Tirane Kashar KASHAR

Objekti i aktivitetit:

Hoteleri

## PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE

**DHE**

## SHENIMET SHPJEGUESE

*Periudha Kontabil:* 01/01/2016 - 31/12/2016

*Monedha e paraqitjes:* (te shprehura ne LEKE)

*Shkalla e rrumbullakimit:*

*Data e bilancit:* 15.03.2017

Drejtuesit e njësise ekonomike kanë vlerësuar mundësinë për vazhdimësinë e aktivitetit dhe deklarojnë se veprimtaria ekonomike e saj do të ketë vijimësi dhe se nuk ka në plan apo ta ketë të nevojshme ta ndërprejë aktivitetin edhe për 12 muaj pas kësaj date.

Administratori

Anest Rahmani



Pasqyra e Pozicionit Financiar (BILANCI KONTABEL)

Periudha Kontabël: 01/01/2016 - 31/12/2016

(te shprehura në LEKE)

Nr.	AKTIVET	Shenime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Ndryshimi +/-
I.	<b>Aktivët afatshkurtra</b>				
1	Mjetet monetare	4	944,298.9	83,298.6	861,000.3
2	Investime:		-	-	-
2.1	Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda grupit				-
2.2	Aksionet e veta				-
2.3	Të tjera financiare				-
3	Të drejta të arkëtueshme:	5	21,448,087.0	30,676,114.5	(9,228,027.5)
3.1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit				-
3.2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit				-
3.3	Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse				-
3.4	Të tjera	5.1	21,448,087.0	30,676,114.5	(9,228,027.5)
3.5	Kapital i nënshkruar i papaguar				-
4	Inventarët:	6	-	-	-
4.1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme				-
4.2	Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte				-
4.3	Produkte të gatshme				-
4.4	Mallra				-
4.5	Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)				-
4.6	AAGJM të mbajtura për shitje				-
4.7	Parapagime për inventar				-
5	Shpenzime të shtyra				-
6	Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara				-
	<b>Aktive totale afatshkurtra (1+2+3+4+5+6)</b>		<b>22,392,385.9</b>	<b>30,759,413.1</b>	<b>(8,367,027.2)</b>
II.	<b>Aktive afatgjata</b>				
1	<b>Aktive financiare:</b>		-	-	-
1.1	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit				-
1.2	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit				-
1.3	Tituj pronësie në njësitë ku ka interesa pjesëmarrëse				-
1.4	Tituj të huadhënies në njësitë ku ka interesa pjesëmarrëse				-
1.5	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata				-
1.6	Tituj të tjerë të huadhënies				-
2	<b>Aktivët materiale:</b>	7	18,682,937.3	18,682,937.3	-
2.1	Toka dhe ndërtesa	7	18,682,937.3	18,682,937.3	-
2.2	Implante dhe makineri				-
2.3	Të tjera instalime dhe pajisje				-
2.4	Parapagime për aktive materiale dhe në proces				-
3	<b>Aktive Biologjike</b>				-
4	<b>Aktive jo materiale:</b>		-	-	-
4.1	Koncesione, patenta, licenca, marka & të drejta të ngjashme				-
4.2	Emri i Mirë				-
4.3	Parapagime për AAJM				-
5	<b>Aktive tatimore të shtyra</b>				-
	<b>Aktive totale afatgjata (1+2+3+4+5)</b>		<b>18,682,937.3</b>	<b>18,682,937.3</b>	<b>-</b>
	<b>AKTIVE TOTALE (I+II)</b>		<b>41,075,323.3</b>	<b>49,442,350.4</b>	<b>(8,367,027.2)</b>

Pasqyra e vecante e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shenimet, të cilat janë pjesë perberëse e ketyre Pasqyrave Financiare

Administratori  
Anest Rahmani





Pasqyra e Pozicionit Financiar (BILANCI KONTABEL)

Periodha Kontabël: 01/01/2016 - 31/12/2016 (te shprehura ne LEKE)

Nr.	DETYRIME DHE KAPITALI	Shenime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Ndryshimi +/-
I. 1	<b>Detyrime afatshkurtra:</b>	8	8,370.0	7,771,171.0	(7,762,801.0)
1.1	Titujt e huamarrjes				-
1.2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë				-
1.3	Arkëtime në avancë për porosi				-
1.4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	8.1	-	7,506,088.0	(7,506,088.0)
1.5	Dëftesa të pagueshme				-
1.6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit	8.2	-	-	-
1.7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëm.				-
1.8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sig.shoqërore	8.3	8,370.0	265,083.0	(256,713.0)
1.9	Të pagueshme për detyrimet tatimore				-
2	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara				-
3	Të ardhura të shtyra				-
4	Provizione				-
	<b>Totali i Detyrimeve afatshkurtra (1+2+3+4)</b>		<b>8,370.0</b>	<b>7,771,171.0</b>	<b>(7,762,801.0)</b>
II. 1	<b>Detyrime afatgjata:</b>		-	-	-
1.1	Titujt e huamarrjes				-
1.2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë				-
1.3	Arkëtime në avancë për porosi				-
1.4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit				-
1.5	Dëftesa të pagueshme				-
1.6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit				-
1.7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëm.				-
1.8	Të tjera të pagueshme				-
2	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara				-
3	Të ardhura të shtyra				-
4	Provizione:		-	-	-
4.1	Provizione për pensionet				-
4.2	Provizione të tjera				-
5	Detyrime tatimore të shtyra				-
	<b>Totali i Detyrimeve afatgjata (1+2+3+4+5)</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>Detyrime totale (I+II)</b>		<b>8,370.000</b>	<b>7,771,171.0</b>	<b>(7,762,801.0)</b>
III.	<b>Kapitali dhe Rezervat</b>				
1	Kapitali i Nënshkruar	9	42,000,000.0	42,000,000.0	-
2	Primi i lidhur me kapitalin				-
3	Rezerva rivlerësimi				-
4	Rezerva të tjera:	9	(386,847.6)	-	(386,847.6)
4.1	1. Rezerva ligjore				-
4.2	2. Rezerva statufore				-
4.3	3. Rezerva të tjera(humbje)		(386,848)		(386,847.6)
5	Fitimi i pashpërndarë				-
6	Fitim / Humbja e Vitit	9	(546,199.2)	(328,820.6)	(217,378.6)
	<b>Totali i Kapitalit (1+2+3+4+5+6)</b>		<b>41,066,953.3</b>	<b>41,671,179.4</b>	<b>(604,226.3)</b>
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>41,075,323.3</b>	<b>49,442,350.4</b>	<b>(8,367,027.2)</b>

Pasqyra e vecante e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet, te cilat jane pjese perberese e ketyre Pasqyrave Financiare

Administratori  
Anest Rahmani

*Rahmani*



**Pasqyra e Performancës (Të ardhurat dhe shpenzimet sipas natyrës)**

Periudha Kontabël: 01/01/2016 - 31/12/2016

(të shprehura në LEKE)

Nr.	Pershkrimi	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Ndryshimi +/-
I. 1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit				-
2	Ndryshimi në produktet e gatshme dhe prodhimin në proces				-
3	Puna e kryer nga njësi ekonomike dhe e kapitalizuar				-
4	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit				-
II. 1	<b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme:</b>		<b>(116,916.7)</b>	<b>(44,620.0)</b>	<b>(72,296.7)</b>
1.1	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme				-
1.2	Të tjera shpenzime	10	(116,916.7)	(44,620.0)	(72,296.7)
2	<b>Shpenzime të personelit:</b>	<b>11</b>	<b>(420,120.0)</b>	<b>(337,370.0)</b>	<b>(82,750.0)</b>
2.1	Paga dhe shoërbilime	11	(380,000.0)	(289,091.0)	(70,909.0)
2.2	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	11	(60,120.0)	(48,279.0)	(11,841.0)
3	Zhvierësimi i aktiveve afatgjata materiale				-
4	Shpenzime konsumi dhe amortizimi				-
5	Shpenzime të tjera shfrytëzimi				-
III.	<b>Të ardhura të tjera:</b>		-	-	-
3.1	Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse				-
3.2	Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata				-
3.3	Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme				-
IV.	<b>Zhvierësimi i aktiveve &amp; investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra</b>				-
V.	<b>Shpenzime financiare:</b>		<b>(9,162.5)</b>	<b>(4,857.6)</b>	<b>(4,304.9)</b>
5.1	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	12.1	(9,162.5)	(4,857.6)	(4,304.9)
5.2	Shpenzime të tjera financiare				-
VI.	<b>Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet</b>				-
VII.	<b>Fitimi/Humbja para tatimit (I-II+III-IV-V+VI)</b>		<b>(546,199.2)</b>	<b>(386,847.6)</b>	<b>(159,351.6)</b>
VIII.	<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin:</b>		-	<b>58,027.0</b>	<b>(58,027.0)</b>
8.1	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	13	-	58,027.0	(58,027.0)
8.2	Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë	13	-	-	-
8.3	Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve	13	-	-	-
IX.	<b>Fitimi/Humbja e vitit (VII-VIII)</b>		<b>(546,199.180)</b>	<b>(328,820.6)</b>	<b>(217,378.6)</b>

Shënim: Kur shumt paraqiten me shenjen - (minus), ato nënkuptojnë se janë shpenzime/ humbje

Pasqyra e vecante e performancës duhet lexuar së bashku me shënimet, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Pasqyre Financiare

Administratori  
Anest Rahmani





**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**

(metoda indirekte)

(te shprehura ne LEKE)

Periudha Kontabël: 01/01/2016 - 31/12/2016

(te shprehura ne LEKE)		Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015
<b>I. Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>			
- Fitim / Humbja e vitit		(546,199.2)	(328,821.0)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>			
- Shpenzimet financiare jomonetare		328,820.6	-
- Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		-	(58,027.0)
- Shpenzime konsumi dhe amortizimi		-	X
- Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	X
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>			
- Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			(X)
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>			
- Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		1,465,226.5	(22,904,944.0)
- Rënie/(ritje) në inventarë		-	(X)
- Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(7,506,088.0)	22,634,588.0
- Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		(256,713.0)	265,083.0
<b>Mjete monetare neto nga/ përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</b>		<b>1,247,847.9</b>	<b>(23,233,764.0)</b>
<b>II. Fluksi i Mjeteve Monetare nga/përdorur në aktivitetin e investimit</b>			
- Para neto të përdorura për blerjen e filialeve			(X)
- Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve			X
- Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		-	(18,682,937.0)
- Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	X
- Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		-	(X)
- Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		-	X
- Dividentë të arkëtuar		-	X
<b>Mjete monetare neto nga/përdorur në aktivitetin e investimit</b>		<b>-</b>	<b>(18,682,937.0)</b>
<b>III. Fluksi i Mjeteve Monetare nga/përdorur në aktivitetin e financimit</b>			
- Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		(386,847.6)	42,000,000.0
- Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral			X
- Hua të arkëtuara			X
- Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë			(X)
- Riblerje e aksioneve të veta			(X)
- Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral			(X)
- Pagesa e huave			(X)
- Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare			(X)
- Interes i paguar			(X)
- Dividendë të paguar		-	(X)
<b>Mjete monetare neto nga/përdorur në aktivitetin e financimit</b>		<b>(386,847.6)</b>	<b>42,000,000.0</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>		<b>861,000.3</b>	<b>83,299.0</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar</b>		<b>83,298.6</b>	
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare			
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>		<b>944,298.9</b>	<b>83,299.0</b>

0.0

Administratori  
Anest Rahmani



**Pasqyra e ndryshimeve në Kapitalin Neto**

Perioda Kontabël: 01/01/2016 - 31/12/2016

Monevnia e punëdhejës: (te shprehura ne LEKE)

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva e Rryhorësim	Rezerv Statutore	Rezerva të tjera	Fiturmet e Paanpendar	Fitim/ Humbja	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali Gjithesgj
<b>I. Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013</b>	42,000,000.0	-	-	-	-	-	-	42,000,000.0	-	42,000,000.0
- Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						(X)	(X)	-		-
<b>II. Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014</b>	42,000,000.0	-	-	-	-	-	-	42,000,000.0	-	42,000,000.0
<i>Te ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:</i>										
- Fitimi / Humbja e vitit							(328,820.6)	(328,820.6)		(328,820.6)
- Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse										
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>							(328,820.6)	(328,820.6)		(328,820.6)
<i>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura drekt në kapital:</i>										
- Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-							-		-
- Dividende të paguar	-							-		-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	-							-		-
<b>III. Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014</b>	42,000,000.0	-	-	-	-	-	(328,820.6)	41,671,179.4	-	41,671,179.4
<i>Te ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:</i>										
- Fitimi / Humbja e vitit							(546,199.2)	(546,199.2)		(546,199.2)
- Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse										
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>							(546,199.2)	(546,199.2)		(546,199.2)
<i>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura drekt në kapital:</i>										
- Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-							-		-
- Dividende të paguar	-							-		-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	-							-		-
<b>V. Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015</b>	42,000,000.0	-	-	-	-	(386,847.6)	(546,199.2)	41,066,953.3	-	41,066,953.3



Administratori  
 Apetit Rahmani



## SHENIMET SHPJEGUESE

### 1 Informacion i pergjithshem

Shoqëria "LA PLAZA AL" Sh.p.k është themeluar më 05/03/2015 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Kapitali i shoqërisë është 42.000.000 lekë e ndarë në 2 kuota nga të cilat 80 % zotërohen nga ortaku Sarah Rosa Frans Broedersi dhe 20% nga z.Liman Domi.

Kjo shoqëri është regjistruar si shoqëri tregtare në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit" dhe administrohet në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Pë tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ajo zhvillon aktivitet në qytetin e Tiranës dhe përreth saj. Administratori i shoqërisë është z. Anest Rahmani, i cili ka përgatitur dhe nënshkruar këto pasqyra financiare, të cilat do të paraqiten për miratim në asamblenë e përgjithshme.

### 2 Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të Përmirësuar nga 1 deri 14. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të të drejtave & detyrimeve të konstatuara, parimit të vijimësisë si dhe parimeve të tjera bazë të parashikuara në SKK1 i Përmirësuar.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9228, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", pasqyrat financiare janë përgatitur në Lek, ndërsa informacioni është paraqitur në mijë lekë duke pëdorur rumbullakim të shifrave në qindëshen më të afët.

### 3 Përmbledhje e politikave më të rëndësishme kontabël

**Matja fillestare** e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes janë bërë me koston historike, përveç rasteve kur Standardet kërkojnë matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Ndërsa **matja e mëpasshme** e aktiveve dhe detyrimeve financiare, është bërë me kosto historike ose me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sic parashikohet në SKK1 i Përmirësuar.

Sipas SKK1 i Përmirësuar për aktivet, **kosto historike** është shuma e mjeteve monetare të paguara ose vlera e drejtë e shumës së dhënë për të blerë aktivin në momentin e përftimit të tij. Për detyrimet, kostoja historike është shuma e mjeteve monetare të marra në këmbim për detyrimin në kohën e lindjes së këtij të fundit, ose në disa rrethana është shuma e mjeteve monetare që pritet të paguhet për të shlyer detyrimin në rrjedhën normale të biznesit.

**Kostoja historike e amortizuar** është kostoja historike e një aktivi ose detyrimi plus ose minus atë pjesë të koston së tij historike njohur më parë si shpenzim ose e ardhur.

Sipas SKK3 i përmirësuar, të gjitha të drejtat e arkëtueshme (p.sh Kërkesa të arkëtueshme afatshkurtra -klientë, Kërkesat e arkëtueshme nga njësi të tjera të grupit, Kërkesat e arkëtueshme nga njësi ekonomike mbi të cilat ushtrohet një ndikim i ndjeshëm apo ku ka investime të tjera financiare, Kërkesa të arkëtueshme nga palë të tjera të lidhura -debitorë të tjerë), paraqiten në Pasqyrat Financiare me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Lidhur me kontabilizimin e inventarëve është përzgjedhur **metoda e koston mesatare të ponderuar**, sic parashikohet në standardin përkatës.

#### 3.1 Transaksionet e këmbimeve në monedhë të huaj.

Transaksionet e kryera në monedha të tjera janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në këto monedha janë rivlerësuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivët dhe detyrimet jomonetare në këto monedha janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit.

Kurset e këmbimit të aplikuar (nga monedhë e huaj në Lekë) për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

Nr.	Lloji monedhes	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2015
1	Monedha Europiane (EUR)	137.28	135.28
2	Dollari Amerikan (USD)	125.79	128.17

#### 3.2 Ndryshimet në politikat kontabël

Sipas SKK1 i Përmirësuar, ndryshimi në politikat kontabël zakonisht zbatohet në retrospektivë, d.m.th. sikur politika e re të ishte zbatuar gjithnjë. Informacioni krahasues i periudhave kontabël të mëparshme rishihet në mënyrë të tillë që ai të jetë i paraqitur në përputhje me politikën e re kontabël. Teprica e çeljes së fitimeve të pashpërndara rregullohet me qëllim që ajo të reflektojë ndryshimet për një ose më shumë periudha kontabël të mëparshme.



Nuk ka patur ndryshime të politikave kontabël në këtë periudhë raportuese, efektet e të cilave janë rregulluar në tepriçën e çeljes së fitimeve të pashpërndara.

### 3.3 *Ndryshimet në Paraqitjen e Pasqyrave Financiare*

Paraqitja e informacionit financiar përfshirë formatet e pasqyrës së pozicionit financiar, pasqyrës së performancës financiare, pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrës së ndryshimeve në kapital, kanë ndryshuar bazuar në kërkesat e Standardeve Kombëtare të Përmirësuara, të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 01 Janar 2015.

Standardet Kombëtare të Përmirësuara i lejojnë njësisë ekonomike të paraqesë performancën në dy pasqyra financiare (një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe një pasqyrë të të ardhurave gjithëpërfshirëse). Sipas këtij koncepti, totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse është diferenca aritmetike ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, të realizuara dhe atyre të porealizuara. Gjithashtu edhe paraqitja e informacionit krahasues të periudhave kontabël paraardhëse të paraqitura në pasqyrat financiare, kanë ndryshuar me qëllim që ato të korrespondojnë me paraqitjen e re.

### 3.4 *Ndryshimet në vlerësimet kontabël*

Sipas SKK1 i Përmirësuar, një ndryshim në vlerësimin kontabël është një rregullim i vlerës kontabël neto të një aktivi ose detyrimi, ose shumës së konsumit periodik të një aktivi, që rezulton nga vlerësimi i gjendjes aktuale dhe përfitimeve të pritshme të ardhshme dhe detyrimeve lidhur me aktivin dhe detyrimin.

Ndryshimet në vlerësimet kontabël rezultojnë prej informacionit të ri apo zhvillimeve të reja dhe, rrjedhimisht, nuk janë korigjime të gabimeve. Si psh. a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve; b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit; c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.

Sipas SKK1 i Përmirësuar, ndryshimet në vlerësimet kontabël njihen gjatë periudhës kontabël kur ato kanë ndodhur, dhe jo në retrospektivë.

Nuk ka patur ndryshime në vlerësimin kontabël të cilat kanë rezultuar me rregullim të vlerës kontabël neto të një aktivi ose detyrimi.

### 3.5 *Korigjimi i gabimeve materiale*

Sipas SKK1 i Përmirësuar, gabimet janë mosraportime ose deklarime të gabuara në pasqyrat financiare të një ose më shumë periudhave kontabël, të cilat vijnë nga mospërdorimi ose keqpërdorimi i informacionit të disponueshëm nga drejtuesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare.

Gabimet materiale të periudhave kontabël të mëparshme do të korigjohen:

(a) në retrospektivë, që do të thotë se shuma e korigjimit të një gabimi material, që lidhet me periudhat kontabël të mëparshme, do të raportohet duke rregulluar tepriçën e çeljes së fitimeve të pashpërndara, ose

(b) duke riparuar tepricat e çeljeve për aktivet, detyrimet dhe kapitalin e periudhës më të hershme të mëparshme të paraqitur, në rastet kur gabimi ka ndodhur përpara periudhës më të hershme të paraqitur.

Nëse një gabim është bërë gjatë një periudhe kontabël para periudhës krahasuese ose gjatë periudhave kontabël edhe më të hershme, tepricat e çeljes së aktiveve, detyrimeve dhe fitimeve të pashpërndara të periudhës aktuale dhe asaj krahasuese korigjohen.

Gabimet jomateriale duhet të korigjohen në periudhën kontabël aktuale. Korigjimi i gabimeve jomateriale në retrospektivë nuk lejohet.

Nuk janë konstatuar gabime materiale të cilat kanë rezultuar me rregullim të tepriçës së çeljes së fitimeve të pashpërndara, ose korigjim të tepriçave të çeljes së aktiveve, detyrimeve dhe fitimeve të pashpërndara të periudhës aktuale dhe asaj krahasuese.

### 3.6 *Ngjarjet materiale pas dates se bilancit*

Sipas SKK1 i Përmirësuar, kontabilizimi i ngjarjeve që ndodhin pas mbylljes së periudhës raportuese, por para datës kur pasqyrat financiare autorizohen për t'u publikuar, varet nga fakti nëse këto ngjarje janë të tilla që kërkojnë rregullim ose jo.

Ngjarja pas periudhës raportuese për të cilën duhet të bëhen rregullime, është një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese. Një njësi ekonomike duhet të rregullojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare, duke përfshirë dhënie e informacioneve përkatëse shpjeguese, për të pasqyruar ngjarjet rregulluese pas përfundimit të periudhës raportuese.

Ngjarjet, për të cilat nuk bëhen rregullime janë ngjarjet që nuk evidentojnë kushtet që kanë ekzistuar pas mbylljes së periudhës raportuese. Njësi ekonomike nuk do të korigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarjet për të cilat nuk bëhen rregullime, pas përfundimit të periudhës raportuese.



Nuk janë konstatuar ngjarje pas periudhës raportuese, të cilat kanë rezultuar me rregullim të tepërcës së çeljes së fitimeve të pashpërndara, ose korigjim të tepërcave të çeljes së aktiveve, detyrimeve dhe fitimeve të pashpërndara të periudhës aktuale dhe asaj krahasuese.

### 3.7 Parimi i Vijmësisë

Pasqyrat financiare përgatiten sipas parimit të vijmësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e njësisë ekonomike do të ketë vijmësi dhe njësi ekonomike nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, drejtuesit kanë vlerësuar mundësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar aktivitetin e saj dhe se drejtimi deklaron se veprimtaria ekonomike e saj do të ketë vijmësi dhe se nuk ka në plan apo ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj edhe për 12 muaj pas datës së pasqyrave financiare.

## A- Shpjegimet e zerave të Aktiveve

### 4 Mjete monetare

Sipas SKK3 i përmirësuar, në këtë zë përfshihen mjetet monetare në arke dhe banke, llogari rrjedhese, investime në tregun e parase dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj. Bazuar në SKK3 i përmirësuar, matja e tyre është bërë me vlerën e drejtë. Vlerat monetare në monedhe të huaja janë vlerësuar në Leke, bazuar në kursin fiks të Bankes së Shqipërisë.

Gjendja e tyre në arke dhe në banke paraqitet si më poshte:

Nr.	Emertimi	Gjendja në fillim të periudhës	Hyrije	shenimi 4	
				Dalje	Gjendja në fund të periudhës
4.1	Mjete monetare në arke (531)	69,912.9	20,102,000.5	20,136,578.4	35,335.0
1	BKT NE LEK	9,921.2	6,108,000.0	6,116,663.0	1,258.2
2	BKT NE EUR	3,464.5	13,386,000.0	12,481,758.8	907,705.7
4.2	Mjete monetare në banke (512)	13,385.8	19,494,000.0	18,598,421.8	908,963.9
	<b>Totali</b>	<b>83,298.6</b>	<b>39,596,000.5</b>	<b>38,735,000.2</b>	<b>944,298.9</b>

### 5 Te drejta të arkëtueshme

Sipas SKK3 i përmirësuar, kur një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësi duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

#### 5.1 Të tjera të drejta të arkëtueshme

Gjendja e të drejtave të tjera të arkëtueshme, në fillim dhe në fund të periudhës kontabel paraqitet si më poshte:

Emertimi	shenimi 5.1	
	Gjendja në fillim të periudhës	Gjendja në fund të periudhës
- TVSH (4453)	3,746,587.5	3,746,587
- Tatim fitimi i shtyre	58,027.0	30,000
- Te drejta ndaj ortakeve	26,871,500.0	17,671,499.51
<b>Shuma:</b>	<b>30,676,114.5</b>	<b>21,448,087</b>

### 6 Inventari



Sipas SKK 4 i permiresuar, Inventarët janë aktivet:

(a) e mbajtura për shitje në rrjedhën normale të njësisë ekonomike

(b) që ndodhen në procesin e prodhimit, ose

(c) në formë materialeve ose furnizimesh për t'u përdorur në procesin e prodhimit ose në kryerjen e shërbimeve.

Vlera kontabël është vlera me të cilën është njohur një aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Pas njohjes, një njësi ekonomike duhet të matë inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur. Për të përcaktuar koston e lëndëve të para që përdoren në prodhim dhe pjesët e këmbimit që blihen shpesh dhe me çmime të ndryshme, është përdorur mesatarja e ponderuar. Po kështu, për të llogaritur koston e inventareve që kanë të njëjtën natyrë dhe përdorim për njësinë ekonomike, është përdorur e njëjta formulë.

#### Zhvlerësimi i inventarit

Sipas SKK4, inventaret duhet t'i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit. Kërkesa për vlerësimin e inventarit me vlerën më të ulët mes koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur e detyron njësinë ekonomike që të regjistrojë në kontabilitet humbjet nga zhvlerësimi në momentin kur ky i fundit ndodh. Zvogëlimet për të arritur në çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur mund të ndodhin në ato raste kur ka një rënie të çmimeve të shitjes ose kur shpenzimet e përfundimit apo shpenzimet direkte të shitjeve janë rritur. Ka dhe raste kur disa produkte dëmtohen përpara se të shiten ose kur disa të tjerë mund të mbahen në sasira të tilla që nuk mund të shiten brenda një periudhë kohe të arsyeshme. Në raste të tilla, kostoja e inventarit duhet të zvogëlohet për të arritur në çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

#### 7 Aktive afatgjata materiale (AAM)<sup>6</sup>

Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në kosto përfshihet:

(a) kosto e blerjes (përfshirë taksat e importit dhe taksa të tjera të parimbursueshme dhe zbritur skontot tregtare dhe rabatet)

(b) kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të njësisë (përfshirë koston e prodhimit të aktivit, nëse ka të tilla kosto, koston e përgatitjes së terrenit, lëvrimin fillestar dhe trajtimin, instalimin dhe montimin, dhe testimin e tij).

(c) kostoja e vlerësuar fillestare e çmontimeve të ardhshme të një aktivi dhe të kthimit të terrenit, në të cilin ai ndodhet në gjendjen fillestare, nëse vlerësimi i tyre përputhet me politikat për krijimin e një provizioni, siç përshkruhet në SKK 6.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Vlera kontabël neto është shuma me të cilën një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar (pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi). Metoda e zgjedhur për amortizimin e AAM-ve është metoda lineare e amortizimit.

Në pasqyrën e meposhtme paraqitet gjendja dhe ndryshimi i AAM, amortizimi i llogaritur si dhe vlera neto e tyre gjatë periudhës kontabël:

Nr.	Emertimi	Gjendja në fillim të periudhës	Shtesa	shenimi 7	
				Pakesime	Gjendja në fund të periudhës
1	Toka (211)				-
2	Ndertesa (212)	18,682,937.3	-		18,682,937.3
-	Minus Amortizimi (2812)				-
	<b>Vlera neto</b>	<b>18,682,937.3</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>18,682,937.3</b>
	<b>Totali i vlerës neto</b>	<b>18,682,937.3</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>18,682,937.3</b>
<b>Nga keto:</b>					
	<i>Blerje dhe shitje gjatë periudhës</i>		-	-	
	<i>Rivlerësime gjatë periudhës</i>				

#### B- Shpjegimet e zerave të Detyrimeve dhe Kapitalit

##### 8 Detyrime afatshkurtra



Sipas SKK3 i permiresuar, kur një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e trasaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësi duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Për mallrat, produktet e shërbimet e blera nga një furnizues me kredi afatshkurtër, njihet një llogari e pagueshme me shumën e paskontuar që i detyrohet furnizuesit, që është zakonisht çmimi i faturës.

8.1 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Gjendja e furnitoreve gjate periudhes kontabel paraqitet si me poshte:

	shenimi	8.1
Furnitore per mallra, produkte e sherbime ne fillim te periudhes (401)		7,506,088.0
Shtesat gjate periudhes kontabel (Blerjet)		1,588,026.370
Pakesimet gjate periudhes kontabel (Pagesat)		9,094,114.370
<b>Gjendja e detyrimeve ndaj furnitoreve ne fund te periudhes</b>		-

8.2 Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit

Sipas udhezimit te Keshillit Kombetar te Kontabilitetit (KKK), ne kete ze perfshihen: Letra me vlerë për hua të marra afatshkurtra ose për blerje me kredi nga njësi të tjera brenda grupit. Ato paraqiten me koston e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem.

Detyrimet ndaj aksionereve paraqiten si me poshte:

Emertimi	shenimi 8.2	
	Gjendja ne fillim te periudhes	Gjendja ne fund te periudhes
- Ortake – Hua te tjera (455)	-	-
<b>Totali</b>	-	-

8.3 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sig.shoqërore

Sipas udhezimit te Keshillit Kombetar te Kontabilitetit (KKK), ne kete ze perfshihen: Pagat dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore për t'u paguar. Gjendja e ketyre detyrimeve gjate periudhes paraqiten si me poshte:

Emertimi	shenimi 8.3	
	Gjendja ne fillim te periudhes	Gjendja ne fund te periudhes
- Paga e shperblime (421)	256,713.0	-
- Sigurimet Shoq & shendetesore (431)	8,370.0	8,370.0
<b>Totali:</b>	<b>265,083.0</b>	<b>8,370.0</b>

9 Kapitali dhe Rezervat

Detaje te gjendjes dhe ndryshimit te kapitaleve paraqiten ne tabelen e vecante. Ndersa gjendja e llogarive te kapitalit ne fillim dhe ne fund te periudhes paraqitet si me poshte:

Emertimi	shenimi 9	
	Ne fund te vitit te meparshem	Gjendja ne fund te periudhes
- Kapitali aksionar (101)	42,000,000.0	42,000,000
Fitim / Humbja e mbartur		(388,848)
- Fitim / Humbja e vitit financiar (121)	(328,820.6)	(546,199.18)
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>41,671,179.4</b>	<b>41,066,953</b>

Nga keto:

- Emetimi i kapitalit të nënshkruar		-
- Dividendë të arketuar		
- Dividendë të paguar		

C- Shpjegimet e te Ardhurave & Shpenzimeve

10 Të tjera shpenzime

Sipas udhezimit te KKK, ne kete grup shpenzimesh perfshihen Kostoja e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse: të blera për qëllime administrative dhe të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit (për shembull, kostoja e shërbimeve për mbajtjen e llogarive, shpenzimet për këshillim, shpenzimet për zyrën, shpenzimet e reklamave, shpenzimet e nisjes, punës kërkimore dhe të zhvillimit, etj.) Gjithashtu, paraqiten dhe kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Keto lloj shpenzimet gjate periudhes kontabel paraqiten si me poshte:

shenimi 10
------------



Emertimi	Ne fund te vitit te meparshem	Gjendja ne fund te periudhes
- Shpenzime nga humbje nga kursi (669)	30,000.0	49,916.7
- Tatime e taksa vendore (634)	14,620.0	67,000.0
<b>Totali</b>	<b>44,620.0</b>	<b>116,916.7</b>

## 11 Shpenzimet e personelit

Sipas udhezimit te KKK, ketu perfshihen pagat, shperblimet, pagat per lejet vjetore, festat dhe kompensime te tjera monetare e jomonetare gjate periudhes kontabel, pavarësisht nga fakti nëse ato janë paguar ose jo.

Po keshtu paraqiten dhe sigurimet shoqërore dhe primi i sigurimit per papunësinë, paguar nga njësia ekonomike raportuese. Shpenzimet e njohura në bazë të konstatimeve të të drejtave dhe detyrimeve, në lidhje me pensionet dhe përfitime të tjera të punonjësve të paguara ose për t'u paguar nga njësia ekonomike raportuese ( duhet paraqitur veçmas)

Shpenzimet e kryera nga shoqëria per personelin gjate periudhes kontabel paraqiten:

Emertimi	shenimi 11	
	Ne fund te vitit te meparshem	Gjendja ne fund te periudhes
- Pagat e personelit (641)	289,091.0	360,000.0
- Kontributi sig.shoqërore (644)	48,279.0	69,120.0
<b>Totali</b>	<b>337,370.0</b>	<b>429,120.0</b>

## 12 Shpenzime financiare

### 12.1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Sipas udhezimit te KKK, ne kete ze paraqiten:

(i) Fitimi/humbja nga investime të tjera financiare afatgjata, duke përfshirë fitimin/humbjen nga shitja e investimeve financiare afatgjata; të ardhurat nga interesi dhe dividendi mbi investimet financiare afatgjata; fitimi/ humbja nga rivlerësimet për të arritur në vlerën e drejtë

(ii) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit mbi huat, bonot, marrëveshjet e qirasë financiare dhe hua të tjera me interes

(iii) Fitimi/humbja nga investime financiare afatshkurtra, duke përfshirë ato nga shitja e investimeve financiare afatshkurtra; të ardhurat nga interesi dhe dividendet mbi investimet financiare afatshkurtra; fitimi/humbja nga rivlerësimet e vlerës së drejtë.

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare te realizuara nga shoqëria gjate periudhes kontabel pasqyrohen ne tabelen e meposhtme:

Emertimi	shenimi 12.1	
	Ne fund te vitit te meparshem	Gjendja ne fund te periudhes
<b>Fitime/ Te ardhura</b>	<b>10.4</b>	<b>-</b>
- Të ardhura nga interesat (767)	10.4	-
<b>Humbje/ Shpenzime</b>	<b>4,868.0</b>	<b>9,162.5</b>
- Shërbime bankare (628)	4,868.0	9,162.5
<b>Totali</b>	<b>4,857.6</b>	<b>9,162.5</b>

## 13 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Sipas SKK11 i përmirësuar, një njësi ekonomike duhet të njohë një provizion kundrejt aktivitetit tatimor të shtyrë, në mënyrë që vlera kontabel neto e tij të barazojë vlerën më të lartë që ka më shumë mundësi të realizohet sesa bazuar në fitimin e tatueshëm aktual apo të ardhshëm.

Po keshtu, një njësi ekonomike duhet të rishikojë vlerën kontabel neto të një aktiviteti tatimor të shtyrë në çdo datë raportuese dhe duhet të rregullojë shumën e provizionit për të reflektuar vlerësimin aktual të fitimeve të tatueshme të ardhshme. Rregullime të tilla duhet të njihen në fitim ose humbje, përveç rastit kur një rregullim ka lidhje me një zë që është njohur në kapital në përputhje me ndonjë SKK tjetër, i cili duhet gjithashtu të njihet në kapital.

Shpenzimi tatimor aktual dhe shpenzimi tatimor i shtyrë ngarkohet ose kreditohet drejtpërdrejt në kapital, nëse ai ka të bëjë me zëra që janë njohur ose ngarkuar drejtpërdrejt në kapital, në të njëjtën periudhë kontabel, ose në një periudhë tjetër kontabel (p.sh. rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale)

Shpërndarja e tatimit aktual dhe të shtyrë tek elementët përkatës të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të pasqyrës së ndryshimeve në kapital paraqitet si me poshte:

Emertimi	shenimi 13	
	Ne fund te vitit te meparshem	Gjendja ne fund te periudhes
- Shpenzimi/ E ardhura aktuale e tatimit mbi fitimin (694)	(58,027.0)	-
- Shpenzimi / E ardhura e tatim fitimit të shtyrë (695)		
- Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve (696)		
<b>Totali</b>	<b>(58,027.0)</b>	<b>-</b>



Me poshte po paraqesim perilogaritjen e kryer per tatimin mbi fitimin:

**Llogaritja e rezultatit**

<b>Te ardhurat dhe shpenzimet</b>		<b>Te ushtrimit</b>	<b>Tatimore</b>
- Te ardhurat		-	-
- Shpenzimet		546,199.18	546,199.2
- Shpenzimet e pazbriteshme			
<b>Rezultati</b>			
- Humbja			
- Fitimi		(546,199.2)	(546,199.2)
- Humbje e mbartur			
- Fitimi i tatueshem neto			(546,199.2)
<b>Llogaritja e tatim fitimit</b>			
- Tatim fitimi me shkallen tatimore standarde (15%)			
- Tatim fitimi me përqindje të tjera			
- Tatim fitimi aktual			-
- Tatim fitimi i shtyre			
- Parapagime			
- Tatim fitimi per t'u paguar			-

HARTUESI I PASQYRAVE FINANCIARE

